

Gjergj Elez Alia

-Pyetje me shtjellim-

PJESA E DYTË

-shënime-

1.

*Nanë e tatë kah kalben për nën bli,
trupi i vllaut varrue q'nandë vjet në shpi,
trupi i motrës n'dorë t'balozit t'zi!*

Elementi që i lidh këto tre vargje është trupi në gjendje të ndryshme. Cilat janë këto gjendje?

15. (Pyetje shitesë)

*Nanë e tatë kah kalben për nën bli,
trupi i vllaut varrue q'nandë vjet në shpi,
trupi i motrës n'dorë t'balozit t'zi!*

Elementi që i lidh këto tre vargje është trupi në gjendje të ndryshme (i kalbur, i plagosur, i shnderuar). Megjithatë ka diçka të përbashkët ky element në të tre gjendjet. Cila është e përbashkëta?

16. (Pyetje shitesë)

*Nanë e tatë kah kalben për nën bli,
trupi i vllaut varrue q'nandë vjet në shpi,*

Tek fjala varrue kemi një asosacion të qëllimshëm idesh. Cili është dhe ç'ide jep?

2.

Pasi merr vesh kërkesat e balozit, motra e sheh gjendjen të pashpresë dhe shpëtimin e nderit të pamundur. Ku duket kjo (gjeni vargje për ta ilustruar këtë)?

3.

Pse mallkimet dhe urimet janë elementë tipikë të baladave dhe këngëve legjendare. Gjeni në tekstin e këngës një mallkim të tillë.

-shënime-

4. Dialogun motër-vëlla rapsodi e pasuron me disa detaje të goditura. Cili është funksioni stilistik i tyre?

*Qat'her Gjergji dorn' ia ka shtërngue,
mirë po e lmon me ato duert e shtatit,
mirë po e kqyr me ata sytë e ballit.*

.....

*Sa mirë motra vllaut po m'i përgjigjë,
dorn' e vllaut tu balli e paska vndue...*

20. (Pyetje shtesë)

Tipike e rapsodive legjendare janë përsëritjet e vargjeve të tëra. Gjeni disa nga këto përsëritje dhe jepni një shpjegim për arsyen e ekzistencës dhe rolit të tyre.

5.

Shpjegoni lidhjen në çift të fjalëve të nënvizuara, siç na e sugjeron rapsodi:

*Qysh s'u njom ky shtat që nand pranvera?
Si s'u tha kjo motër, thafta-e vera?*

22. (Pyetje shtesë)

Ç'lloj fjale është për nga ndërtimi fjala motërzeza? Si është formuar ajo?

6. (Pyetje shtesë)

Shpjegoni përdorimin e shpeshtë të habitores në këngët e këtij tipi.

6.

Gjeni disa nga klisjetë e përdorura në këngë.

Ndihmë:

Klishe - ide, mendim ose shprehje, që është përdorur shpesh dhe përsëritet njësoj. Në këtë rast klisheja ka kuptimin e një formule të gatshme që përdoret e pandryshuar kudo.

-shënime-

25. (Pyetje shitesë)

Gjytet-shehër, gjog-at, mejdan-log... etj.

Si e shpjegoni praninë e fjalëve të ndryshme sllave, turke, etj. në këngët legjendare si kjo e Gj. E. Alisë?

7.

Figurat e dy nallbanëve janë episodike. Ata nuk kanë lidhje me konfliktin qendror të këngës. Cili është roli i tyre?

27. (Pyetje shitesë)

Ku duket që figurat e dy nallbanëve janë episodike dhe shërbejnë veç për të ndriçuar më mirë figurën e motrës së Gjergjit?

8.

Cilat janë dy kuptimet e mundshme të fjalëve të nallban probatinit:

*...ta kam pshtue vlla Gjergjin prej mejdanit
e e baj gjogun me fjurue si era.*

29. (Pyetje shitesë)

Cili është kuptimi i fjalës probatin?

9.

Komentoni fuqinë artistike të përgjigjes të motrës së Gjergjit propozimit të probatinit:

*Se kta sy nji herë unë ua kam falë
tats' e nans' qi kalben për nan dhe,
Gjergjit tem qi kalbet varrsh' mbi dhe!*